



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË

Nr. 3779 Prot.

Datë 09.07.2015

MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE E SPORTIT

Nr. 5246 Prot.

Datë 14.07.2015

UDHËZIM

Nr. 21 datë 09.07.2015

PËR  
PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË NXËNËSVE NGA NJË NIVEL/DREJTIM I  
ARSIMIT PROFESIONAL NË GJIMNAZ

Në mbështetje të Nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 12, pika 2, të Ligjit Nr. 8872, datë 29.03.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë":

UDHËZOJMË:

1. Transferimi i studimeve nga arsimi profesional në gjimnaz mund të bëhet vetëm për nxënësit që kanë përfunduar klasën e 10-të në shkollat profesionale me kohë të plotë.
2. Nxënësit që kërkojnë të transferojnë studimet nga arsimi profesional në gjimnaz, duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në nenin 23, pika 2 të Ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
3. Për të realizuar transferimin, nxënësit duhet të plotësojnë lëndët e detyruara në planin mësimor të gjimnazit duke dhënë provime të veçanta për lëndët e munguara dhe një provim të integruar për pjesët/orët e munguara të lëndëve të përbashkëta.
4. Vendimi për numrin e lëndëve të munguara dhe provimin e integruar merret nga drejtoria e shkollës dhe ruhet e trajtohet si pjesë e dokumentacionit shkollor.
5. Procedurat e transferimit nga arsimi profesional në gjimnaz, përfshirë dhe dhënien e provimeve për lëndët/pjesët e munguara, fillon në përfundim të vitit shkollor dhe duhet të përfundojë para fillimit të vitit të ri shkollor.
6. Transferimi i nxënësit nga një shkollë e mesme profesionale në gjimnaz, bëhet me kërkesë të prindërve ose kujdestarit ligjor të nxënësit;
7. Procedura e realizuar në shkollë për transferimin e nxënësit nga arsimi profesional në gjimnaz, duhet të paraqitet për miratim në njësinë arsimore vendore përkatëse.

8. Drejtoritë e shkollës pritëse dhe shkollës nga transferohet nxënësi, pasqyrojnë shënimet përkatëse në amzë.
9. Nxënësit shqiptarë dhe të huaj, të cilët transferojnë studimet në shkollat profesionale nga jashtë shtetit në Shqipëri, duhet të japin provime për lëndët/praktikat profesionale të munguara.
10. Nxënësit shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në Shqipëri, për vitet e ndërmjetme, bëjnë njehsimin e studimeve të kryera. Procedura e njëvlershmërisë së studimeve në këtë rast bëhet në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bazë të dokumentacionit original të përkthyer dhe noterizuar.
11. Nxënësit që duan të transferojnë studimet e kryera në arsimin profesional jashtë shtetit, në gjimnaz, duhet të plotësojnë kriteret e transferimit të përshkruara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi.
12. Për nxënësit shqiptarë ose të huaj që kanë ndjekur studimet në një shkollë të mesme të përgjithshme jashtë shtetit dhe dëshirojnë të transferohen në shkollat profesionale në Shqipëri, ky transferim nuk mund të bëhet.
13. Dokumentacioni dhe vendimet e marra për procesin e transferimit ruhet në sekretarinë e shkollës dhe është objekt i inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale e Zyrrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MIRËQËNIES  
SOCIALE DHE RINISË**

**BLENDËKLOSI**



**MINISTRI I ARSIMIT  
DHE I SPORTIT**

**LINDITA NIKOLLA**

